



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.983/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULI, dhe zyrtaren ligjore Amire Jahiri, në kontestin tregtar-administrativ të paditësit “N.S.” B.I me adresë biznesi Glavna BB, Shtërpcë kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë duke vepruar sipas padisë së paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti – rivlerësim tatimor, vlerë kontesti e pa përcaktuar, jashtë seance, me datë 09.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET SE ËSHTË TËRHEQUR padia KF.nr.983/22 e datës 21.10.2022 e paditësit “N.S.” B.I me adresë biznesi Glavna BB, Shtërpcë, për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore.

A R S Y E T I M

Paditësi “N.S.” B.I me adresë biznesi Glavna BB, Shtërpcë, me padinë e datës 21.10.2022 ka iniciuar në këtë Gjykatë kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, me bazë juridike: Anulim Vendimi nr.354/2022 të datës 16.09.2022 , objekt kontesti-rivlerësim tatimor.

Gjykata me datën 30.01.2023, paditësit “N.S.” B.I me adresë biznesi Glavna BB, Shtërpcë, ia ka dërguar vërejtjen për pagimin e taksës gjyqësore në padi në shumën prej 50 euro, me afat pagese prej 15 ditësh nga dita e pranimit, mirëpo edhe pas pranimit të kësaj vërejtje, pala paditëse nuk e ka paguar taksën gjyqësore në afatin ligjor (provë: fletë kthesën e pranuar nga paditësi “N.S.” B.I me adresë biznesi Glavna BB, Shtërpcë me datë 02.02.2023).

Në bazë të nenit 253 par. 4 të Ligjit nr. 03/L-006, për Procedurën Kontestimore (LPK-ë), i aplikuar përshtatshëmrisht sipas nenit 63 të LKA-së, ligji nr. 03/L-202, paditësi ka për detyrë që padisë t’ia bashkëngjit edhe vërtetimin mbi taksën e paguar gjyqësore, ndërsa sipas paragrafit 5, të po këtij neni, nëse paditësi edhe pas vërejtjes së dërguar

nga ana e Gjykatës nuk e paguan taksën gjyqësore, ndërsa nuk ekzistojnë kushtet për lirim të tij nga pagesa e taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.

Duke marrë për bazë faktin si më lartë se është konstatuar se paditësi edhe përkundër vërejtjes së Gjykatës të pranuar me datë 02.02.2023 sipas fletë kthesës nuk e ka paguar taksën gjyqësore për padi, dhe as nuk ka paraqitur kërkesë për lirim, Gjykata konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore për ta konsideruar të tërhequr padinë e paditësit në këtë kontest tregtar-administrativ konform nenit 253, paragrafi 4 dhe 5 të LPK-së, Ligji nr. 03/L-006 i aplikuar përshtatshëm sipas nenit 63, të LKA-së, Ligji nr. 03/L-202, prandaj Gjykata nuk është lëshuar më tej në vendosje sipas padisë.

Duke marrë parasysh të lartcekurat, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 81.C. të Ligjit nr. 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për ATK-së dhe Procedurat nr.03/L-222, nenit 253, paragrafi 4 dhe 5, të LPK-së i aplikuar përshtatshëm sipas nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Parë / Departamenti Fiskal

KF.nr.983/2022, datë 09.01.2024

Zyrtare Ligjore

Amire JAHIRI

Gj y q t a r i

Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.